

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJITIKES

MIRATOHET
MINISTRI

GENC RULI

RREGULLORE
PER
KRITERET DHE PROCEDURAT E DHENIES SE
LIÇENSAVE PROFESIONALE NE PROJEKTIM,
VLERESIM, KONSULENCE, MONITORIM
DHE DREJTIMIN TEKNIK
TE VEPRIMTARISE MINERARE

Tirane, Maj 2007

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.7796, date 17.02.1994 “Minerar te Shqiperise”, te ndryshuar dhe ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.54, date 28.01.2005, i ndryshuar me VKM Nr.271, date 10.05.2006, Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes nxjerr kete Rregullore:

KREU I

Dispozita te Pergjitheshme

Neni 1

Objekti i rregullores dhe fusha e veprimit

Kjo rregullore percakton dhe shtrin fushen e veprimit ne:

1. Organizimin dhe funksionimin e strukturave qe merren me procedurat e licensimit te objekteve qe kryejne projektimin, vleresimin e konsulencen, monitorimin dhe drejtimin teknik te veprimtarise minerare.
2. Klasifikimin dhe kategorizimin e punimeve te projektimit, vleresimit, konsulences, monitorimit ne veprimtarine minerare si dhe te drejtimit teknik ne kete veprimtari.
3. Kushtet dhe kriteret qe duhen plotesuar per t’u pajisur me licenshe profesionale.
4. Te drejtat qe kane personat fizike dhe juridike per t’u pajisur me licenshe ne veprimtarine minerare, ndryshimet qe u behen atyre dhe detyrimin e administrates shtetere per realizimin e trajtimin konform dispozitave ligjore te kerkesave te personave fizike dhe juridike.

Neni 2

Perkufizimi i termave

“**Komision**” - Komision i posaçem, qe krijohet nga Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, per dhenien e licensave profesionale ne fushen minerale te kerkim-zbulimit, shfrytezimit, perpunimit (pasurim dhe shkrirje), rehabilitimit te mjedisit pas shfrytezimit dhe matje ne veprimtarine minerare.

“**Licenshe profesionale**” - Dokument juridik e profesional, me te cilin pajiset çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, qe deshiron te ushtroje profesionin ne veprimtari minerare sipas klasifikimit, ne projektim, vleresim, konsulence, monitorim dhe drejtim ne veprimtarine minerare.

“**Vjetersi ne pune**” - Vite pune gjithesej, dokumentuar me libreze pune.

“**Klase – Kategori**” – Klasifikimi i puneve ne projektim, vleresim, konsulence, monitorim dhe drejtim ne veprimtarine minerare, sipas llojeve dhe nenllojeve.

“**Kartele shoqeruese e kerkeses**” - Fleta evidentuese qe shoqeron çdo kerkese me shenimet perkatese te punonjesve te Departamentit Minerar, nga pranimi deri tek Vendimi i Komisionit.

“**AKBN**” - Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore

KREU II

Organizimi dhe Funksonimi i Strukturave per Dhenien e Liçensave Profesionale Komisioni i Posaçem per Dhenien e Liçensave Profesionale

Neni 3

Krijimi – Perberja

1. Komisioni i posaçem i dhenies se liçensave profesionale krijohet ne zbatim te Ligjit Minerar, prane Agjensise Kombetare te Burimeve Natyrore; perberja e komisionit, kryetari, nenkryetari, sekretari dhe anetaret, behet me urdher te Kryetarit te Agjensise Kombetare te Burimeve Natyrore.
2. Anetaret e komisionit jane specialiste me aresim te larte te fushes se projektimit dhe zbatimit ne veprimtarine minerare, me vjetersi pune jo me pak se 10 vjet.
3. Komisioni ushtron veprimtarine e tij ne perputhje me kete rregullore, aktet ligjore e nenligjore ne fuqi, qe percaktojne kriteret ne veprimtarine minerare.
4. Komisioni merr vendime per dhenie liçense profesionale personale dhe per persona fizike dhe juridike, shtesa dhe rinovime te liçensave profesionale, **ndryshime te drejtuesve te shoqerise, regjistrim, mbyllje dhe çregjistrim te shoqerise, ne kushtet e percaktuara ne kete rregullore.**

Neni 4

Mbledhjet e Komisionit

1. Komisioni thirret ne mbledhje nga kryetari i tij.
 - **Si rregull, ai mblidhet çdo muaj ndermjet datave 25-30**
 - **Me kerkese te Kryetarit te Komisionit mblidhet dhe jashte radhe.**
2. Mbledhjet e komisionit jane te vlefshme kur marrin pjese jo me pak se tre te katertat e komisionit
 - Ne mungese te Kryetarit dhe me autorizim te tij, mbledhjet mund te drejtohen nga n/Kryetari i Komisionit.
3. Ne mbledhje te radhes komisioni shqyrton dhe vendos per kerkesat, ankesat dhe informacionet e paraqitura para dates 20, te muajit ne vazhdim.
4. Mbledhjet e komisionit jane te mbyllura dhe ne te mbahet protokoll.

Neni 5

Pergatitja e materialeve per komision

1. Rendi i dites per mbledhjen e radhes se komisionit, hartohet nga Sekretari i Komisionit dhe miratohet nga Kryetari i tij.
2. Materialet qe do te shqyrtohen ne mbledhje u shperndahen anetareve te komisionit nga sekretari i tij, jo me vone se tri dite para dites se caktuar per mbledhje.

Neni 6

Marrja e vendimeve

1. Komisioni merr vendim jo me vone se 45 dite nga dorezimi i dokumentave per liçensim
2. Vendimet ne komision merren me konsensus, kur ky nuk arrihet me shumicen e votave te pjesmarresve
 - Ne rastet kur votimi rezulton i barabarte, vota e kryetarit eshte percaktuese.
3. Vendimet e komisionit, nen pergjegjesine e sekretarit te tij, nenshkruhen nga kryetari dhe pjestaret e komisionit qe kane qene ne mbledhje.
 - Vendimet e komisionit pergatiten ne tri kopje, njera dorezohet ne zyren e protokoll-arshives, tjetra ne Departamentin Minerar ne AKBN per veprime te metejeshme dhe e treta, ne praktiken e komisionit.
4. **Puna e kryer nga anetaret e komisionit shperblehet**
 - **Shperblimi behet ne raport me te ardhurat qe realizohen nga tarifat perkatese sipas urdherit te Ministrarit.**

Neni 7

Dorezimi dhe pranimi i kerkesave

1. Kerkesa per liçense dhe dokumentat shoqeruese te saj, sipas kesaj rregulloreje, dergohen me poste rekomande.
 - Dokumentat per liçense duhet te jene origjinale ose te fotokopjuara e te noterizuara.
 - Ne faqen e jashtme te zarfit, qe mban adresen e plote te subjektit kerkues, nenshkrimin dhe vulen e tij, shkruhet adresa e AKBN, si dhe shenimi "Dokumenta per liçense profesionale".

2. Zarfat e mbyllur terhiqen çdo dite nga Sekretari i Komisionit, regjistrohen ne protokoll dhe shoqerohen me kartele.
 - Ne kartelen shoqeruese jepet mendimi i Departamentit Minerar ne AKBN per çdo kerkese.
 - Çdo kerkese shqyrtohet brenda dites, nese permban te plote e te sakte te gjithe dokumentacionin perkates sipas kesaj rregullore.
 - Kerkesat qe, pas shqyrtimit, rezultojne te parregullta, nenshkruhen nga Drejtori i Departamentit Minerar dhe Sekretari i Komisionit dhe i percillen te interesuarit, se bashku me sqarimet perkatese.

Neni 8

Ruajtja dhe arshivimi

1. Departamenti Minerar, mbi bazen e vendimit te komisionit, i pergatit licensat ne dy kopje origjinale, njera prej te cilave, pas nenshkrimit nga kryetari, i dorezohet subjektit perkates e vulosur, ndersa tjetra ruhet per arshivim.
2. Licensat profesionale jane dokumenta me vlere, qe i neneshtrohen prodhimit te posaçem dhe kontrollit te rrepte.
 - Formati i licensave propozohet nga komisioni dhe miratohet nga Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes (ose kryetari i AKBN).
 - Departamenti Minerar pergjigjet per arkivimin sipas rregullave ne fuqi te licenses, dokumentacionit, kerkeses dhe mandatit te arketimit per pagesen, sipas tarifes perkatese.
3. Tarifat per personat fizike e juridike, vendas e te huaj qe licensohen, jane sipas nenit 32 te kesaj rregullore.

Neni 9

Komunikimi me subjektet

1. Sekretari i Komisionit komunikon çdo dite, sipas rregullit te brendshem te AKBN, me subjektet e interesuar, argumenton refuzimin pjesor apo te plote te kerkeses dhe jep sqarimet e nevojeshme ne zbatim te kesaj rregullore.
2. Shperndarja e licensave te interesuara behet dorazi nga Sekretari i Komisionit ndermjet datave 10-30 te muajit pasardhes, por jo me vone se 60 dite nga marrja e vendimit.
3. Sekretari i Komisionit i kerkon subjekteve te licensuar respektimin e detyrimeve qe burojne nga kjo rregullore.

Neni 10

Paraqitja - Protokoli - Regjistrat – Arkivi

1. Çdo kerkese dhe dokumentacion shoqerues sipas kesaj rregullore, duhet te jete i daktilografuar dhe ne gjuhen shqipe (dokumentat e perkthyer e te noterizuara).
2. Çdo dokument i fotokopjuar duhet te jete i noterizuar.
3. Protokoli i AKBN mban dhe ruan sipas rregullave ne fuqi dokumentacionin:
 - Protokoll per evidentimin e kerkesave te subjekteve per licensim;
 - Regjister themeltar per licensat profesionale personale dhe te shoqerive;
4. Arkivi i Departamentit Minerar organizohet bashke me arkivin e AKBN.

KREU III

Liçensat profesionale - Klasifikimi - Kushte dhe Kriteria ne Proçedurat e Liçensimit

Neni 11

Liçensat - klasifikimi i tyre

5. Liçensa eshte dokument juridik e profesional, qe i jep te drejte disponuesit te saj te ushtrroje veprimtari ne fushen minerare, sipas klasifikimit, ne projektim, vleresim, konsulence, monitorim dhe drejtim, mbeshtetur ne profilin e diplomes se arsimit te larte, eksperiences ne pune, kushtet dhe kriteret e percaktuara ne kete rregullore.
6. Klasifikimi i veprimtarise minerare qe lidhet me projektimin, vleresimin, konsulencen, monitorimin dhe drejtimin teknik, per te cilat kerkohet liçense profesionale, paraqitet si me poshte:
 - a) Kerkim-zbulim i mineraleve (klasa a)
 - b) Shfrytezim i mineraleve (klasa b)
 - c) Perpunim i mineraleve (klasa c)
Klasa c ndahet ne dy kategori:
 - c/1 pasurimi i mineraleve (klasa c/1)
 - c/2 shkrirja e mineraleve (klasa c/2)
 - d) Rehabilitimi i mjedisit pas shfrytezimit minerar (klasa d)
 - e) Matje ne veprimtarine minerare (klasa e)
5. Liçensat profesionale personale, apo per shoqeri sipas shkalles se aftesimit, afatit kohor, ndryshimeve dhe saktesimeve te mundeshme, rinovohen ne kushtet e percaktuara ne kete rregullore.

Neni 12

Llojet e liçenses dhe elementet e saj

1. Llojet e liçenses janë:
 - Liçense profesionale personale
 - Liçense profesionale për shoqëri
2. Liçensat profesionale personale apo për shoqëri japën për këto veprimtari minerare:
 - Projektim, vlerësim, konsulence dhe monitorim
 - Zbatim
3. Liçensa përmban këto elemente:
 - Klasa dhe kategoria
 - Afati i vlefshmerisë
 - Numri i regjistrit themeltar
 - Shenja dalluese
 - Fotografia e drejtuesit teknik

Neni 13

1. Liçensa nuk lejohet të transferohet nga një person fizik apo juridik të tjetri.
2. Kur një subjekt humbet liçensën profesionale, njofton menjëherë zyrtarisht komisionin e posaçëm dhe pajiset me dublikate sipas kësaj rregullore.

Neni 14

Kufizime në dhenien e liçenses

Nuk lejohet të pajisen me liçense për shoqëri, personat që punojnë në institucionet qendrore apo buxhetore dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bëhet ndesh me Ligjin Nr.8549, datë 11.11.1999 "Për statusin e nepunesit civil" V.K.M. Nr.657, datë 16.09.1996 "Rregullat e etikës në shërbimin civil", ndryshimet e mëvonshme që mund të ndodhin dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 15

Afatet e vlefshmerisë së liçenses

1. Afatet e vlefshmerisë së liçensave nga data e lëshimit të tyre janë:
 - 5 vjet, për liçense profesionale të shoqërive për projektim, vlerësim, konsulence, monitorim dhe zbatim (drejtim teknik në zbatim).

- Pergjithmone, per liçense profesionale per projektim, vleresim, konsulence, monitorim dhe zbatim.

KREU IV

Kushtet Paraprake per te fituar Liçense, Detyrat dhe te Drejtat e Subjekteve qe Liçensohen

Neni 16

Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj per ushtrimin e veprimtarise se tij ne veprimtarine minerare, ka te drejte te paraqese kerkese prane komisionit te liçensave, per t'u pajisur me liçense profesionale personale ose per shoqeri, pasi te kete plotesuar kushtet paraprake qe jepen me poshte:

Kushtet paraprake per liçense profesionale personale ne veprimtarine minerare.

I. Ne projektim (vleresim, konsulence, monitorim), ne veprimtarine minerare

1. Projektues (vleresues, konsulent, monitorues), ne kerkimin dhe zbulimin e mineraleve.
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin Gjeologji-Miniera, ne profilin Gjeologji dhe Gjeofizike.
 - b. Te kete vjetersi ne pune jo me pak se 5 vjet
 - c. Te jete autor ose bashkeautor ne tre projekte te miratuara dhe te zbatuara.
2. Projektues (vleresues, konsulent, monitorues), ne shfrytezimin e mineraleve.
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin Gjeologji-Miniera, ne profilin Shfrytezim Miniere.
 - b. Te kete vjetersi ne pune jo me pak se 5 vjet
 - c. Te jete autor ose bashkeautor ne tre projekte te miratuara dhe te zbatuara.
3. Projektues (vleresues, konsulent, monitorues), ne perpunimin e mineraleve.
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin Gjeologji-Miniera ne profilin Pasurimi i Mineraleve (per kategorie pasurim) dhe Fakultetin e Inxhinierise Mekanike, profili Metalurgji per kategorie e shkrirjes se mineraleve.
 - b. Te kete vjetersi ne pune jo me pak se 5 vjet
 - c. Te jete autor ose bashkeautor ne tre projekte te miratuara dhe te zbatuara.
4. Projektues (vleresues, konsulent, monitorues), ne rehabilitimin e mjedisit pas shfrytezimit minerar.
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin e Inxhinierise se Ndertimit, ne profilin e Inxhinierise se Mjedisit ose Fakultetin Gjeologji-Miniera, profili Shfrytezim Miniere.
 - b. Te kete vjetersi ne pune jo me pak se 5 vjet.

- c. Te jete autor ose bashkeautor ne tre profile te miratuara dhe te zbatuara.
- 5. Projektues (vleresues, konsulent, monitorues), ne matje ne veprimtarine minerare.
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin Gjeologji-Miniera, ne profilin Markshejderi.
 - b. Te kete vjetersi ne pune jo me pak se 5 vjet.
 - c. Te jete autor ose bashkeautor ne tre projekte te miratuara dhe te zbatuara.

II. Ne zbatim (drejtim teknik te punimeve), ne veprimtarine minerare

1. Drejtues teknik (zbatues), ne kerkimin dhe zbulimin e mineraleve.
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin Gjeologji Miniera ne profilin Gjeologji ose Gjeofizike.
 - b. Te kete vjetersi ne pune jo me pak se 2 vjet.
2. Drejtues teknik (zbatues) ne shfrytezimin e mineraleve
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin Gjeologji Miniera, ne profilin Shfrytezim Miniere.
 - b. Te kete vjetersi pune jo me pak se 2 vjet
3. Drejtues teknik (zbatues), ne perpunimin e mineraleve
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin Gjeologji-Miniera ne profilin Pasurim i Mineraleve (per kategorine pasurim) dhe Fakultetin e Inxhinierise Mekanike, profili Metalurgji per kategorine e shkrirjes se mineraleve.
 - b. Te kete vjetersi ne pune jo me pak se 2 vjet.
4. Drejtues teknik (zbatues), ne rehabilitimin e mjedisit pas shfrytezimit minerar.
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin e Inxhinierise se Ndertimit ne profilin Inxhinier Mjedisor ose Fakultetin e Gjeologji-Miniera ne profilin Shfrytezim Miniere.
 - b. Te kete vjetersi ne pune jo me pak se 2 vjet.
5. Drejtues teknik (zbatues), ne matje ne veprimtarine minerare.
 - a. Te kete mbaruar Fakultetin Gjeologji - Miniera ne profilin Markshejderi
 - b. te kete vjetersi ne pune jo me pak se 2 vjet.

III. Liçensa profesionale e shoqerise dhe drejtuesi teknik i saj.

1. Drejtuesi teknik i shoqerise eshte nje ose me shume persona fizike, pajisur me liçense profesionale personale dhe vjetersi ne pune jo me pak se 5 vjet.
2. Shoqeria fiton liçense profesionale mbeshtetur ne liçensen profesionale, personale te drejtuesit/drejtuesve teknike qe ajo ka, kerkesave te tjera qe percaktohen ne kete rregullore dhe vleresimit te komisionit te posaçem per dokumentacionin e paraqitur.
3. Ne asnje rast nuk lejohet qe drejtuesi teknik i shoqerise te jete me arsim te mesem ose arsim te larte te pambaruar (i padiplomuar).
4. Drejtuesi teknik i shoqerise nuk mund te jete njekohesisht i punesuar me kete cilesi ne dy a me shume shoqeri.

5. Drejtuesi/drejtuesit teknike duhet te jene ne marrdhenie pune me shoqerine me shume se nje vit.
6. Marrdheniet e drejtuesit teknik me shoqerine rregullohen me kodin e punes dhe kontrate punesimi.

Neni 17

Shoqeria qe ushtron veprimtari minerare ne projektim (vleresim, konsulence, monitorim dhe ne zbatim, duhet te plotesoje kushtet paraprake te meposhtme qe te fitoje license profesionale:

a) Per projektim (vleresim, konsulence, monitorim)

- Te kete drejtues teknik, nje ose me shume persona fizike te pajisur me license profesionale personale per projektim (vleresim, konsulence, monitorim).
- Te kete aftesi projektuese, etj., burime njerezore, materiale financiare te mjaftueshme.

b) Per zbatim

- Te kete drejtues teknik nje ose me shume persona fizike, te paisur me license profesionale personale per zbatim punimesh.
- Te kete aftesi ne veprimtarine minerare, burime njerezore, materiale e financiare te mjaftueshme.

Neni 18

1. Ne rastet kur drejtuesi teknik i shoqerise se perbashket ose te huaj eshte vendas, zbatohen te njejtat kushte paraprake si per shoqerite vendase.
2. Kur shoqeria e huaj ose e perbashket ka drejtues teknik te huaj, behet ekuivalentimi i licenses se tij (ose shoqerise me klasat dhe kategorite sipas kesaj rregullore) dhe zbatohen te njejtat kushte paraprake si per shoqerite vendase.

Neni 19

Te drejtat dhe detyrat e subjekteve te licensuar

1. Te njohe dhe te kryeje veprimtari minerare ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore per projektim, vleresim, konsulence, monitorim dhe zbatim si dhe me kete rregullore.
2. Te njohe dhe te zbatoje kushtet teknike te projektimit dhe te zbatimit si dhe eurostandartet e pranuar nga vendi yne.
3. Te njohe dhe te zbatoje rregulloren e sigurimit teknik ne pune.

4. Çdo shoqeri e liçensuar nuk duhet të ushtrojë asnjë veprimtari në mungesë të drejtuesit teknik.
 - Drejtuesi teknik i shoqërisë detyrohet të njoftojë tre muaj më parë me shkrim me kërkesë të motivuar drejtuesin ligjor për largimin nga shoqëria.
 - Çdo largim pa arsye, shoqërohet me heqjen jo më pak se një vit të liçensës.
5. Të jete drejtues teknik vetëm në një shoqëri
6. Të paraqesë tek drejtuesi ligjor, kërkesë të noterizuar për prishjen e kontratës.
7. Të kontribuojë me të gjitha aftësitë e tij, në dispozicion, në rastet e emergjencave civile

KREU V

Dokumentat që shoqërojnë Kërkesën për Liçensë Profesionale

Neni 20

Per Liçensë Personale

Kërkesa për pajisje me liçensë profesionale duhet të përmbajë dhe të shoqërohet me:

1. Kërkesë me shkrim në formë autobiografie teknike (Curriculum-Vitae), me keto të dhëna kryesore:
 - Emër, atësi, kombësia, vendlindja, adresa, vendi i punës, numri i telefonit dhe dy kopje fotografi (3x4) cm.
 - Vertetim nga gjykata dhe prokuroria, ku kryen veprimtarinë.
 - Llojet e klasave apo kategorive të punëve që kërkon të kryejë në veprimtarinë minerare.
 - Veprimtarinë e kryer nga marrja e diplomës deri në momentin e kërkesës, vertetuar nga institucionet përkatëse (punëdhësi), shoqëruar me fotokopje të noterizuar të librezës së punës, referenca për objekte të projektuara e të zbatuara.
2. Kopje diplome dhe lista e notave të noterizuara.
3. Kualifikimet apo specializimet dhe kontributet e vecanta, nëpërmjet çertifikatave të leshuara nga organet kompetente.

Neni 21

Per Liçense te Shoqerise

Kerkesa per paisje me liçense profesionale te shoqerise dhe shtesa te mevonshme te saj, duhet te permbaje dhe te shoqerohet:

1. Kerkese me shkrim e motivuar ne forme autobiografie teknike (Curriculum-Vitae), me keto te dhena:
 - Emri, atesia, mbiemri, kombesia, vendblindja, adresa, vendndodhja e drejtuesit ligjor dhe teknik te shoqerise.
 - Veprimtaria minerare qe do te kryeje shoqeria (klasat dhe kategorite), si dhe miratimi i shoqerise.
2. Akti i themelimit, regjistrimi ne gjykate, vertetim nga Gjykata dhe Prokuroria per drejtuesin ligjor dhe teknik.
3. Deklarate, ku thuhet se njeh dhe do te zbatoje ne veprimtarine minerare te saj, rregullat e sigurimit teknik, aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne fushen e veprimtarise minerare.
4. Deklarate e drejtuesit teknik, qe nuk punon si i tille ne ndonje shoqeri tjeter si dhe nuk eshte ne marredhenie pune me shtetin (e noterizuar).
5. Aftesia projektuese apo zbatuese qe ka realizuar dhe mund te realizoje shoqeria, ku parashikohen mjetet, stafi drejtues, referenca per objekte te projektuara dhe te zbatuara.
6. Liçense personale e drejtuesit teknik dhe kopje diplome e noterizuar dhe dy dotografi (3x4) cm.
7. Kontrata e punes ndermjet drejtuesit ligjor te shoqerise dhe drejtuesit teknik te saj (per rastin kur drejtuesi ligjor nuk eshte edhe drejtuesi teknik i saj) e noterizuar.

Neni 22

Per zgjatjen e afatit te liçensave perteritjen e tyre dhe dublikate duhet paraqitur:

1. Kerkese me shkrim e motivuar ku te paraqitet veprimtaria e ushtruar.
2. Deklarate e drejtuesit teknik, qe nuk punon ne institucionet shteterore buxhetore, me vetefinancim ose ne ndonje firme tjeter si drejtues teknik (e noterizuar).
3. Kopje e liçenses dhe e diplomes e noterizuar.
4. Aftesia projektuese dhe zbatuese.
5. Kontrata e drejtuesit ligjor me drejtuesin teknik.
6. Vertetim nga gjykata dhe prokuroria.

7. Per ripërteritje të liçensës profesionale personale (çdo 5 vjet) paraqiten dokumentat sipas pikave 1,3,7

Neni 23

Per ndryshim ose shtese te drejtuesit ligjor te shoqerise

duhet paraqitur:

1. Kerkese me shkrim e motivuar nga shoqeria;
2. Regjistrim ne Gjykate per ndryshim ose shtese drejtuesi ligjor;
3. Kopje e liçensës e noterizuar (e shoqerise).

Neni 24

Per ndryshim te drejtuesit teknik

duhet paraqitur:

1. Kerkese me shkrim e motivuar nga drejtuesi ligjor;
2. Kerkese me shkrim nga drejtuesi teknik per largim (e noterizuar)
3. Kopjet e liçensave dhe diplomave te noterizuara;
4. Kontrate e punesimit midis drejtuesit ligjor dhe personit fizik
5. Deklarate e drejtuesit teknik te ri, qe nuk punon si i tille ne ndonje shoqeri tjeter, si dhe nuk eshte ne marredhenie pune me shtetin (e noterizuar);
6. Vertetim nga Gjykata e Prokuroria;
7. 2 cope fotografi (3x4) cm.

Neni 25

Per ndryshim emertim shoqerie

duhet paraqitur:

1. Kerkese me shkrim e motivuar nga drejtuesi ligjor;
2. Regjistrimi ne Gjykate per ndryshim emertimi;
3. Kopja e liçensës se shoqerise e noterizuar;
4. Vertetim nga Dega e Taksa-Tatime dhe Permbarimi.

Neni 26

Per ekuivalentimin e licenses se subjekteve te huaj

duhet paraqitur:

1. Kerkese me shkrim nga subjekti i huaj;
2. Curriculum Vitae
3. License profesionale e leshuar ne shtetin perkates;
4. Diploma e fotokopjuar e noterizuar
5. Deshmi penaliteti;
6. 2 cope fotografi (3x4) cm.

Neni 27

Mbyllja e aktivitetit te shoqerise. Cregjistrimi

Ne rastin kur subjekti fizik e juridik nuk ushtron me veprimtari minerare, kur nje shoqeri ndahet, bashkohet ose falimenton, kur pjese te saj fitojne cilesi te reja juridike, paraqet prane komisionit kerkese per evidentimin e ndryshimeve.

Ne rastin e mbylljes se veprimtarise minerare, shoqeria paraqet:

- Njoftim me shkrim nga drejtuesi ligjor per cregjistrimin e shoqerise nga libri themeltar i regjistrimit;
- Vendimi i Gjykates;
- Detyrimet ndaj shtetit ne organet tatimore.

Kreu VI

Regjistrimi i Licensave Profesionale dhe Shoqerise

Neni 28

Regjistrimi i licensave profesionale

Licensa hartohet ne dy kopje origjinale dhe regjistrohet ne Regjistrat Themeltare te Licensave Profesionale Personale dhe te Shoqerise, duke pasqyruar edhe permbajtjen e saj.

Regjistrimet duhet te jene te sakta, te qarta, pa korrigjime, me vijueshmeri te numerit rendor dhe pa shkurtime.

Ne Regjistrat Themeltare te regjistrimit nuk lejohet te fshihet asgje.

Rregullimet behen me numer rendor te ri me fraksion. Nje kopje origjinale e licenses se bashku me praktiken e sjelle nga kerkuesi, mbahen ne Protokoll-Arshiven e AKBN.

Neni 29

Regjistrimi i shoqerise

Çdo shoqeri e huaj dhe me kapital te perbashket qe do te ushtroje veprimtari minerare ne fushen e projektimit, vleresimit, konsulences dhe monitorimit, duhet te regjistrohet ne Regjistrin Themeltar te Shoqerise, duke paraqitur dokumentat e kerkuara per licensimin e saj ne nenin 21 te kesaj rregullore.

Kreu VII

Sanksione

Neni 30

Masa disiplinore ndaj subjekteve te licensuar

Heqja e te drejtes per ushtimin e veprimtarise apo pezullimin e perkohshem te saj ne projektim apo zbatim, behet nga Komisioni ne rastet kur:

1. Ne dokumentat qe shoqerojne kerkesen konstatohen deklarime te rreme;
2. Ka fallsifikime te dokumentacionit qe dorezohen prane komisionit te posacem;
3. Kryen veprimtari pa drejtues teknik dhe nuk ploteson detyrimet qe rrjedhin nga kjo rregullore;
4. Drejtuesi teknik largohet pa aresye nga shoqeria;
5. Ka propozime te motivuara nga AKBN ose Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, organet e qeverisjes vendore, tatim-taksa, doganave, etj. per shkelje te ligjshmerise ne veprimtarine minerare;
6. Mospagimi i tarifave te percaktuara ne nenin 32

Per cdo rast, hartohet raport vleresimi dhe shqyrtohet ne mbledhjen e rradhes se komisionit. Masat per shoqerite, drejtuesit teknike dhe personat fizike te licensuar, sipas shkeljeve te bera gjate ushtimit te veprimtarise, jane bere me heqje te se drejtes se ushtimit te aktivitetit te licensuar me 6 muaj, 1 vit, 2 vjet, ose pergjithmone, teresisht ose pjeserisht per klasat dhe kategorite e licenses.

Masat e marra i njoftohen subjektit perkates, deges se tatim-taksave dhe Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes.

Neni 31

Ankimi

Per cdo vendim te Komisionit, ne zbatim te nenit te mesiperme te kesaj rregullore, personat fizike apo juridike, kane te drejten e ankimit tek Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, brenda 40 diteve nga data e publikimit. Ministri, pasi merr ne shqyrtim ankesen e paraqitur nga subjekti, vendos brenda 10 diteve:

- Lenien ne fuqi te vendimit te komisionit;
- Kthen per rishqyrtim vendimin e marre ne komision.

KREU VIII

Dispozita kalimtare dhe te fundit

Neni 32

Per personat fizike e juridike, vendas apo te huaj, qe pajisen me license profesionale, zbatohen keto tarifa:

1. Persona fizike: 6.000 (gjashtemije) leke, çdo vit te vlefshmerise se licenses;
2. Shtese ne license per persona fizike: 4.000 (katermije) leke;
3. Perteritje per persona fizike: 6.000 (gjashtemije) leke;
4. Konvertim license: 15.000 (pesembedhjetemije) leke
5. Persona juridike: 60.000 (gjashtedhjetemije) leke;
6. Shtese license per persona juridike: 20.000 (njezetemije) leke;
7. Zgjatje afati license per persona juridike: 30.000 (tridhjetemije) leke
8. Ndryshim dhe shtese drejtuesi ligjor dhe teknik: 5.000 (pesemije) leke;
9. Ndryshim i emrit te shoqerise: 5.000 (pesemije) leke;
10. Nxjerrje te dhena nga Regjistri Themeltar: 1.000 (njemije) leke
11. Dublikate personave fizike: 3.000 (dymije) leke;
12. Dublikate personave juridike 10.000 (dhjetemije) leke.

Neni 33

Çdo akt i meparshem dhe qe bie ne kundërshtim me kete rregullore, shfuqizohet.